

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Takim sekret SHBA-Huthi në Oman, grupi zotohet të mos sulmojë anijet amerikane
ADRESA	https://dosja.al/bota/takim-sekret-shba-huthi-ne-oman-grupi-zotohet-te-mos-oje-anijet-am-erika-i514456
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 13:11:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 12:45:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4efaa0e3573622efe23a5f2ca459f5dae351b9d602872a2fec3c037e00a4546f
TEKSTI	df15ed1ee5389ccafb148a7be528a801e0ebc2e499fbf4b9899e18a5dae333be
PAMJA	2c8f817b1c9670b6aa818582b1db632dce07532a8a1f12ff426b7dfd053d3a9d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e6aa53a07ccf3e228cc5f1def7fff00e2e3c7d90b6b1a74a93017b0c51aca729
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9235283646fceb4f2e036f737b53ac1b0d6441cb2e31166fde86e3118480b863
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e6aa53a07ccf3e228cc5f1def7fff00e2e3c7d90b6b1a74a93017b0c51aca729>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

2 ORE ME PARE

Haga dënoi Kosovën/ Tensione dhe përplasje jashtë Gjykatës Speciale, familjarët e ish-krerëve të UÇK-së: E papranueshme, do e apelojmë

6 ORE ME PARE

Gjykata Speciale ridënon Kosovën. Bie akuza për krime kundër njerëzimit, po dënimet jepen maksimale. Thaçi & Krasniqi 25 vite burg, 18 Veseli dhe 13 Selimi

17 ORE ME PARE

SYTË NGA HAGA/ Nesër shpallet vendimi për ish-krerët e UÇK-së, rrugët mbushen me flamuj e mbishkrime për Thaçin, Veselin, Krasniqin e Selimin: Shpallini të pafajshëm (PAMJET)

19 ORE ME PARE

108 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën: Edi Rama jep dorëheqjen

Bota

Takim sekret SHBA-Huthi në Oman, grupi zotohet të mos sulmojë anijet amerikane

Takimi u zhvillua me ndërmjetësimin e Omanit, ndërsa Huthit kishin avancuar përgjatë bregdetit të Detit të Kuq dhe kishin marrë kontrollin e pikave strategjike, përfshirë Mocha dhe ishullin Perim.

dosja

16 Shtator 2026, 14:45
Nga G.M



Hudhitë

SHBA- Zyrtarë amerikanë dhe përfaqësues të Huthive zhvilluan një takim të fshehtë gjatë fundjavës në Ambasadën e SHBA-së në Muskat, Oman, në përpjekje për të shmangur përshkallëzimin e konfliktit në Detin e Kuq. Takimi u zhvillua me ndërmjetësimin e Omanit, ndërsa Huthit kishin avancuar përgjatë bregdetit të Detit të Kuq dhe kishin marrë kontrollin e pikave strategjike, përfshirë Mocha dhe ishullin Perim.

Sipas raportimeve nga [mediat e huaja](#), gjatë bisedimeve Huthit u zotuan se nuk do të sulmojnë anijet amerikane ose izraelite dhe se do të respektojnë armëpushimin e arritur më herët me Uashingtonin. Megjithatë, grupi la të hapur mundësinë e sulmeve ndaj anijeve të lidhura me Arabinë Saudite. Takimi vjen në një moment tensioni të lartë në Jemen, ndërsa SHBA-ja po përpiqet të shmangë përfshirjen e drejtpërdrejtë në përplasjen mes Huthive dhe forcave të mbështetura nga Arabia Saudite.

Çfarë u thanë Huthit amerikanëve?

Në takim, për të cilin një burim tha se u zhvillua të dielën, Huthitët i siguruan zyrtarët amerikanë se nuk kanë ndërmend të sulmojnë anijet amerikane dhe se mbeten të përkushtuar ndaj marrëveshjes së armëpushimit të vitit 2025 me Shtetet e Bashkuara, sipas dy burimeve. Një nga burimet, nga Jemeni, tha gjithashtu se grupi tha se nuk do të sulmonte anijet izraelite ose anije të tjera tregtare, me përjashtim të atyre që i përkasin Arabisë Saudite.

Sipas dy burimeve, pala amerikane u përfaqësua nga zyrtarë të ambasadës amerikane. Një nga këto burime tha se delegacioni i Huthit përfshinte Mohammed Abdulsalam , një zyrtar të lartë të grupit me seli në Muscat, i cili është nën sanksione të SHBA-së. Një burim tjetër konfirmoi praninë e Abdulsalam, si dhe një zyrtari tjetër të lartë të Huthit, Abdelmalik al-Ajiri.

editoriale

Irena Begiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 16 SHTATOR 2026, 12:46

DOKUMENTI/ Publikohet vendimi i plotë i dënimit të ish-krerëve të UÇK-së

AKTUALITET 16 SHTATOR 2026, 12:40

"Vendimi i Gjykatës Speciale në Hagë u prit në lot nga qytetarët"/ Reuters: Vendimi u ndoq nga afër edhe Serbi

Uashingtoni nuk e konfirmon takimin

Një zëdhënës i Departamentit të Shtetit, i pyetur nëse Shtetet e Bashkuara ishin takuar me përfaqësuesit e rebelëve Huthi në Oman, nuk pranoi të konfirmonte nëse takimi kishte ndodhur. Megjithatë, ai theksoi se sigurimi i lirisë së lundrimit në Detin e Kuq dhe parandalimi i eksportit të terrorizmit nga Lindja e Mesme janë interesa thelbësore amerikane.

Bisedimet në Oman pasuan një përparim të madh ushtarak nga rebelët Huthi javën e kaluar. Grupi ka marrë në mënyrë efektive kontrollin e të gjithë vijës bregdetare të Detit të Kuq të Jemenit, duke përfshirë portin historik të Mocha dhe ishullin e Perim në ngushticën strategjike Bab el-Mandab.

Ngushtica, e njohur edhe si "Porta e Lotëve", ndodhet në hyrje të Detit të Kuq dhe është një nga korridoret detare më të rëndësishme në botë, duke transportuar pjesën më të madhe të tregtisë midis Evropës dhe Azisë./Dosja.al

- shba
- hudhite
- oman

Sondazh

Poll

Boto

16 Shtator 2026, 08:08

Çmime rekord karburantesh në Gjermani, Merz premton ndërhyrje

Friedrich Merz Çmimet në pikat e karburantit në Gjermani po njohin vetëm një drejtim, rritje rekord. Tani kancela...

SKANDAL në Belgjikë/ Polici godet me shuplakë në fytyrë gruan e prangosur

Boto

16 Shtator 2026, 07:39

Polonia tregon vendosmëri pas një sulmi rus me dronë

Boto

16 Shtator 2026, 07:32

AKTUALITET 16 SHTATOR 2026, 12:09

"Nuk do të na thyejë"/ Vajza e Jakup Krasniqi reagon pas dënimit me 25 vjet: Padrejtësia më e madhe e këtij shekulli

më të klikuarat

Rishfaqet "diMAL", pas mishit të infektuar, drogë në kontejner

Gjykata e Lartë e la në burg Erion Veliajn/ Rama: Sërish Tirana pa kokë, askush nuk do t'ia dijë për koston e kryeqytetit

Daja i saj përdhunoi 34-vjeçaren, reagon Zëgjine Çaushi: Më thanë se do martohen

Kongresmeni Wilson: Qeveria e Ramës po nxit trafikun e narkotikëve. Zv/ndihmës Sekretari Lawton: Organizatat kriminale kanë lidhje me kartelet këtu në SHBA

insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow.

Nafta tërhiqet nga 108 dollarët, por mbetet mbi 105, tregjet druhen për furnizimet globale

[Bota](#)

16 Shtator 2026, 07:26

Sulm rus në Sloviansk të Ukrainës, raportohen dy viktima dhe një e plagosur

[Bota](#)

15 Shtator 2026, 22:45

[Bota](#)

15 Shtator 2026, 22:35

Pentagoni ekspozon krizën e municioneve në SHBA, lufta me Iranin ka kushtuar 33.4 mld dollarë

Pentagoni SHBA- Një raport i ri i inspektorit të përgjithshëm të Departamentit amerikan të Mbrojtjes ka zbuluar kosto të...

Rusia mban zgjedhjet e para që nga nisja e pushtimit të Ukrainës: Gjërat që duhet t'i dini

[Bota](#)

15 Shtator 2026, 21:11

PE-ja kritikon ashpër Serbinë për Mlladiçin

[Bota](#)

15 Shtator 2026, 19:48

Kancelari gjerman Merz përballë krizës në CDU, kërkon mbështetje ose kërcënon me dorëheqje

[Bota](#)


15 Shtator 2026, 18:16

Trump sulmon gjyqtarët e Gjykatës Supreme që emëroi: Nuk janë njerëzit që zgjedha

Bota

15 Shtator 2026, 17:41

MË SHUMË



Pamje prekëse nga Prishtina/ Polici shpërthen në lot kur protestuesit i vendosin pranë flamurit

Haga dënon ish krerët e UÇK-së me 81 vite burg, vogëlusi shpërthen në lot

Haga e dënoi me 25 vite burg, ja si e priti Hashim Thaçi vendimin

Haga dënon ish-krerët e UÇK-së me 81 vite burg, shqiptarët përplasen me policinë pas vendimit

Pamje prekëse nga Prishtina/ Polici shpërthen në lot kur protestuesit i vendosin pranë flamurit

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetare e rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MEMBERSHIP NGA Mediaset

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtor: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.